



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Deliverty	08 - 06	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	SK/DNSH/CIK	3347/2022		
Nr Prot Br Prot Prot No				
Shtesa Prilog Appendix				
Sasia Kolicema Quantity			114	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.444/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave në përbërje: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.A.nr.199/2020 të datës 19.04.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A/02/475/2017 të datës 11.10.2017 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_ i përfaqësuar nga Avokati \_\_\_\_\_ me adresë \_\_\_\_\_ në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A/02/475/2017 e datës 17.08.2017 e parashtruar nga ankuesi
- II. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Pejës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke ia kompensuar ankuesit në mënyrë retroaktive 50% të pagës për periudhën kohore prej datës 14.04.2014 deri me datë 30.03.2015.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Pejës për shkak të heshtjes administrative me datë 17.08.2018 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa Këshilli përmes vendimit me numër A/02/475/2017 të datës 11.10.2017 ankesën e ankuesit e ka hedhur poshtë si të pa lejuar.

Ankuesi kundër vendimi të Këshillit ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa e njëjta përmes Aktgjykimit A.nr.1843/17 të datës 17.12.2019, e ka refuzuar padinë e ankuesit, ndërsa e ka lënë në fuqi vendimin e Këshillit.

Ankuesi i kundër Aktgjykimit A.nr.1843/17 të datës 17.12.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, ku e njëjta përmes Aktgjykimit me numër AA.nr.199/2020 të datës 19.04.2022 të cilin Këshilli e ka pranuar me datës 10.05.2022, e ka anuluar Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative Aktgjykimit A.nr.1843/17 të datës 17.12.2019 dhe po ashtu e ka anuluar edhe vendimin e Këshillit me numër A/02/475/2017 të datës 11.10.2017, ndërsa lëndën e ka kthyer te e paditura në ri-shqyrtim dhe ri-vendosje në Këshill.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në Aktgjykimin me numër A.A.nr.199/2020 të datës 19.04.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, me rastin e shqyrtimit të ankesës së ankuesit ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4097/2017 e datës 17.08.2017 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 14.08.2017; Aktvendimin e Komunës së Pejës i datës 14.04.2014 me numër:02-116-3982; Shkresën e Prokurorisë Themelore në Pejë me numër: PP/I-nr.300/12 e datës 26.03.2015; Shkresën e Prokurorisë Themelore në Pejë e datës 29.03.2016 me numër: PP-nr.195/2015; Shkresën e Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Pejës të datës 02.04.2015; Vërtetimin e Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Pejës i datës 12.06.2017 me numër:02-112/01-0068077/1; Kërkesën e ankuesit drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave për pagesën e ndryshimit në pagë të datës të datës 22.06.2017; Formularin e datës 22.06.2017 për paraqitjen kërkesës apo ankesës; Zarfin postar me shifër R.nr.2105886; Përgjigjen në kërkesë e datës 22.09.2017; Formularin për ankesë apo kërkesë të datës 20.09.2017; Akt emërimin e datës 04.01.2012; Zarfin postar R5692807; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.08.2017; Vendimin e Këshillit me numër A/02/475/2017 të datës 11.10.2017; Flete kthesën e datës 12.09.2017; Fletë kthesën e datës 23.10.2017; Aktgjykimin me numër A.A.nr.199/2020 të datës 19.04.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative; Padinë e paditësit të datës 22.01.2020 e pranuar në Këshill me datë 31.01.2020; Aktgjykimin A.nr.1843/2017 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 17.12.2019; Procesverbalin e seancës së Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 17.12.2019; Autorizimin e lëshuar nga Kryetari i Këshillit i datës 16.12.2019; Procesverbalin mbi shqyrtimin përgatitor të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 07.11.2019; Procesverbalin mbi shqyrtimin përgatitor të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 07.11.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të bashkëngjitura në lëndë si dhe duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A.A.nr.199/2020 të datës 19.04.2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative, konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi *është e bazuar, sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave në bazë të shkresave të lindës ka konstatuar se, ankuesi sipas aktit të emërimit të datës 04.01.2012 me numër:01-112-96 është i punësuar në Komunën e Pejës në pozitën *"Zyrtar i lartë juridik për transfer të pronës"* në kuadër të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, ndërsa sipas vendimit të Aktvendimit të Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Pejës me numër:02-116-3982 është pezulluar nga puna me 50% të pagës për shkak se Gjykata Themelore në Pejë përmes Aktvendimit nr.126/14 të datës 10.04.2014 ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda në lëndën PP.I.nr.300/12 të datës 07.04.2014 për caktimin e masës së pezullimit me arsyetim për shkeljen e supozuar se ankuesi ka kryer vepër penale sipas nenit 334 paragrafi 3, neni 23 dhe 249 paragrafi 1 të KPK.

Po ashtu në bazë të shkresave të lëndës, respektivisht njoftimin e Prokurorisë Themelore në Pejë të datës 26.03.2015 me numër: PP/I-nr.300/12 bëhet e ditur se ndaj ankuesit kanë pushuar pjesërisht hetimet në mungesë të provave, ndërsa sipas Vërtetimit të datës 12.06.2017 me numër: Nr.02-112/01-0068077/1 të lëshuar nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Pejës është konstatuar fakti se ankuesi nga data 14.04.2014 ka qenë i pezulluar nga puna me pagesë prej 50% të pagës ndërsa me datë 30.03.2015 është kthyer në vendin e punës dhe pas kësaj date paga ka filluar t'i kompensohet sipas aktit të emërimit, ndërsa ankuesi me datë 22.06.2017 i është drejtuar Komisionit për Zgjedhjen Kontesteve dhe të Ankesave të Komunës së Pejës për kompensimin e pagës prej 50% për kohën sa ka qenë i pezulluar, mirëpo komisioni në fjalë ka heshtur.

Andaj në kuptim të paragrafit 1 të nenit 135 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Përpos kur ligji parasheh një afat të ndryshëm, akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës"* dhe në mbështetje të nenit 127 paragraf 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"* Kolegji konstaton ankuesi e parashtruar ankesën në Këshill brenda afateve të përcaktuara si në 127 paragraf 4 i të njëjti ligj.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit për kompensimin e ndalesës së pagës prej 50% për periudhën kohore nga data 14.04.2014 deri me datë 30.03.2015, bazuar në nenin 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, është përcaktuar se: *"Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës"*, konstaton se në bazë të këtij paragrafi të këtij neni periudha e mungesës në punë do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të marrë rrogën e plotë, andaj në këtë kuptim pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara ndërsa Komuna e Pejës është e obliguar që ankuesit t'ia bëjë pagesën në mënyrë retroaktive për

pjesën e pa paguar të pagës prej 50% për periudhën kohore nga data 14.04.2014 deri me datë 30.03.2015.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
Lënda me numër A.nr. 444/2022

**Flakron GASHI**

  
Procesmbajtës

**Jeton KOCA**

  
Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokatit
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Menaxherit të Personelit në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.